

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit

Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister


Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	COZ/2625-2-2022
DATË:	18.11.2022
PËR/ZA/TO:	Naim Shala – Drejtor i Departamentit Ligjor / Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
CC:	Fahrije Ternava – Sekretare e Përgjithshme / Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv.Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Urim Salihu – Zyrtar i Lartë Ligjor Divizioni i të Drejtës së BE-së Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse " <i>Projektligji për Pagat në Sektorin Publik</i> "

I nderuar z.Shala,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për "*Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik*".

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelaria Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Pravna Kancelaria - Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

18.11.2022

Departamenti Ligjor në Ministrinë e Punëve të Brendshme me datë 14 nëntor 2022, bazuar në Nenin 7, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka dorëzuar për shqyrtim me urgjencë në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit “*Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik*”¹.

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e “*Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik*” me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti përfundimtar i “*Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik*” (*shqip, sërbisht, anglisht*); dhe
- Deklarata e Përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis* të BE-së (*shqip, sërbisht, anglisht*).
- Memorandumi Shpjegues

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nënparagrafi 1.3, Nenit 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative Divizioni i së Drejtës së BE-së në Zyrën e Kryeministrit, më 18 nëntor 2022 lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje fizike dhe elektronike më datën 14 nëntor 2022 me numër të referencës 2625.

¹ Emri i Projektligjit është transkriptuar saktësisht siç gjendet në tekstin burimor të kërkesës së datës 14/11/2022. Institucioni i linjës ka kërkuar trajtimin me urgjencë të këtij Opinioni.

5. HYRJE

Qëllimi i "Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik" është krijimi i një sistemi të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik, që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.² Ky Projektligj i ka gjashtë (6) kapituj, dyzetepesë nene (45) dhe pesëmbëdhjetë (15) shtojca.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT
Në kuadër të BE-së, fushëveprimi i projekt-aktit në fjalë nuk është i rregulluar specifikisht me legjislacion të BE-së. Rrjedhimisht as sistemi i pagave dhe shpërblimet për punën nuk janë të rregulluara. Pavarisht kësaj, parime të përgjithshme për pagë të barabartë për punë të njëjtë në aspektin gjinor janë të shkruara në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) respektivisht nenin 157 (ish-neni 141 i TKE), i cili përcakton se:

"Neni 157 (ish-neni 141 TKE)³

1. Secili Shtet Anëtar siguron që të zbatohet parimi i pagës së barabartë për punonjësit meshkuj dhe femra për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.
2. Për qëllimin e këtij neni, "pagë" do të thotë rroga e zakonshme bazë ose minimale dhe çdo lloj tjetër kundërvlefte, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i jep punonjësit drejtpërdrejt ose tërthorazi, nisur nga marrëdhëniet e punës.
Pagë e barabartë pa diskriminim për shkak të gjinisë do të thotë:
(a) që paga për të njëjtën punë të normuar të llogaritet në bazë të së njëjtës njësi matjeje;
(b) që paga për punë të matur me kohë të jetë e njëjtë për të njëjtin pozicion pune.
3. Parlamenti Evropian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legjislative dhe pasi konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social, miratojnë masa për të siguruar zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e punësimit dhe profesionit, duke përfshirë parimin e pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.
4. Me qëllimin për të siguruar barazi të plotë në praktikë midis burrave dhe grave në punë, parimi i trajtimit të barabartë nuk e pengon asnjë Shtet Anëtar të mbajë ose miratojë masa që parashikojnë avantazhe konkrete për t'ia bërë më të lehtë gjinisë më pak të përfaqësuar që të ndjekë një aktivitet profesional ose për të parandaluar ose kompensuar pozitat e pafavorshme në karrierat profesionale."

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore, gjegjësisht neni 23, ku garantohet "*barazia midis grave dhe burrave në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën*".

Zbatimi i këtij parimi detajohet mëtej në Direktivën 2006/54/Ec e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit.⁴ Neni 14 i direktivës në fjalë ndalon diskriminimin direkt dhe indirekt në fushën e punësimit mbi baza gjinore, *inter alia* edhe pagën si në sektorin publik ashtu edhe privat.

Në nivel të BE-së, nuk ka rregulla më specifike lidhur me këtë fushë sepse konsiderohet se rregullimi i hollësishëm i saj është në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

² Neni 1 i projektligjit, 14 nëntor 2022

³ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, faqe 114, shih: <http://integrimi-ne-be.punetesjshme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/9-Versioni-i-Konsoliduar-i-Traktateve-te-BE-se.pdf>

⁴ Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32006L0054&from=EN>

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

I. Në aspektin përmbajtësor dhe ligjor,

Duke ju referuar pikës 6 të këtij Opinioni ligjor, dispozitat e “Projektligjit për Pagat në Sektorin Publik” nuk rregullohen në nivel të BE-së dhe si rrjedhojë ky projektligj nuk transponon ndonjë akt të së drejtës së BE-së.

II. Në aspektin teknik,

Të gjitha dokumentet e tjera janë dërguar dhe plotësuar sipas Manualit për plotësimin e tabelave të përputhshmërisë dhe deklaratës së përputhshmërisë, përveç përkthimeve në gjuhë zyrtare.

8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË

Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projekt-aktit. Përgjegjësia e Divizioni të së Drejtës së BE-së vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues (MPB), është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projekt-akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt aktit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.⁵

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Në kuadër të BE-së, parimisht sistemi i pagave dhe shpërblimeve në punë, në administratë publike në shtetet anëtare nuk është e rregulluar specifikisht me legjislacion të BE-së. Mirëpo, në nivel të BE-së ka parime të përgjithshme të trajtimit të barabartë në punë dhe profesion të përcaktuara në TFBE dhe që reflektohen në Direktivën 2006/54/EC. Rrjedhimisht si e tillë kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së.

Me respekt,

Ujim Salihu



Zyrtarë i Lartë Ligjor për Legjislacion të BE-së
Divizioni për të Drejtën e BE-së
Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit

⁵ E qasshme në: <http://www.mci-ks.net/sq/dokumente-ndiezuesc-mbi-procesin-e-perafinit>.